

STRATEGJIA PER ZHVILLIMIN E SEKTORIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE NE SHQIPERI

1. HYRJE

Ne zbatim te programit te qeverise dhe porosive te Presidentit te Republikes, te cilat vene theksin ne nevojën urgjente te rishikimit te strategjise afatgjate te zhvillimit te sektorit te pyjeve dhe kullotave, DPPK ka punuar per hartimin e nje strategjie me te plote te ketij sektori.

Rishikimi i strategjise se zhvillimit te sektorit te pyjeve dhe kullotave kushtezohet nga situata e veshtire e ketij sektori e krijuar pas viteve 90. Aktiviteti i ketij sektori megjithese shtrihet ne me shume se 50% te siperfaqes se vendit ka nevoje per ndryshime thelbesore si ne fushen e menaxhimit ashtu edhe ne ate te kontrollit ne perputhje me politikat e qeverise per kete sektor dhe per mjedisin ne teresi.

Vendimi i fundit i qeverise, per te forcuar ruajtjen dhe funksionimin e te mirave publike te pyjeve dhe kullotave dhe ndalimin e perkohshem te shfrytezimit tregetar te burimeve pyjore, ben te nevojshme rishikimin dhe perditesimin e Strategjise per zhvillimin e sektorit te pyjeve dhe kullotave.

Strategjia per Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave ka si qellim sigurimin e menaxhimit dhe zhvillimit te qendrueshem e shumefunksional te burimeve pyjore dhe kullosore ne perputhje me politikat qeveritare te synuara ne kete sektor.

Konservim i vazhdueshem, perdorimi racional dhe vleresimi i drejt i te mirave publike te eko - sistemeve pyjore dhe kullosore, ne perputhje me interesat e shtresave te ndryshme te popullsisë realizohet nepermjet nje qeverisje te qendrueshme e shumefunksionale.

Ajo ka nevoje te koordinohet me strategjite globale dhe rajonale qe lidhen dhe kushtezohen me ruajtjen dhe mireadministrimin e qendrueshem te burimeve natyrore (pyjeve dhe kullotave).

Strategjia e Zhvillimit te Sektorit te Pyjeve e Kullotave hartohet duke u mbeshtetur ne zhvillimet social – ekonomike te vendit, reduktimit te varferise ne zonat rurale, ndryshimeve thelbesore qe kane ndodhur e do te ndodhin ne drejtim te levizjeve demografike dhe nevojës per nje vleresim shumefunksional te burimeve pyjore e kullosore ku do te veqonim: pyjet si burim energjie, si burim i prodhimeve paresore dhe biomases, si burim i diversitetit biologjik dhe i sekuestrimit te karbonit etj.

Strategjia percakton linjat kryesore te sektorit ne 25 vitet e ardhshem. Ajo perben nje program kombetar per pyjet dhe kullotat, nje pakete veprimesh qe do te zbatohen per 10 vitet e ardheshme, ne bashkepunim me partneret.

2. RENDESIA E STRATEGJISE SE PYJEVE DHE KULLOTAVE

Strategjia e sektorit të pyjeve dhe kullotave përben një dokument që përcakton drejtimet strategjike afatgjata për zhvillimin e këtij sektori.

Për përmbushjen e objektivave strategjike, të mishëruara në planin e veprimit synohet ruajtja dhe rivendosja e ekuilibreve natyrore të burimeve pyjore e kullimore, administrimi i qëndrueshëm i sistemeve të prodhimit pyjor e kullor si dhe arritja e një kontributi optimal të sektorit të pyjeve dhe kullotave në rritjen e përgjithshme ekonomike, luftimin e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë.

Në këtë stad të ri të integritit të Shqipërisë në strukturat Europiane, pas një periudhe të mbishfrytëzimit, mbikullotjes dhe keqadministrimit të burimeve natyrore, pyjore e kullimore, për motive politike e social-ekonomike, bëhet i rëndësishëm hartimi i një strategjie të re për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave, çka do të ndikonte në shkurtimin e periudhës së tranzicionit.

Kjo strategji ka një rëndësi të veçantë gjithashtu sepse:

- Jep orientimet baze të zhvillimit të strukturave administrative, institucioneve politike dhe organeve që do të udhëheqin zbatimin e programeve të zhvillimit të këtij sektori.
- Thekson lidhjet dhe rëndësinë themelore të sektorit të pyjeve dhe kullotave për plotësimin e objektivave të zhvillimit të sektoreve të tjera si atij të bujqësisë, blegtorisë, energjetikës, ujërave, turizmit, zhvillimit rural në përgjithësi, duke mundësuar përmirësimin e planifikimit ndërsektorial dhe koordinimit të programeve të zhvillimit të vendit.
- Kontribuon në rritjen e vetedijes së autoriteteve të larta vendim-marrëse e administrative, komuniteteve të përdoruesve të burimeve natyrore, pyjore e kullimore, e publikut në përgjithësi, për një kuptim më të qartë lidhur me kontributin e mundshëm të sektorit pyjor e kullor në zhvillimin e përgjithshëm kombëtar, për ta mbështetur atë me politikën, autoritetin dhe burimet financiare të nevojshme.
- Bën më të realizueshëm mbështetjen e organizmave ndërkombëtare partnere të interesuara për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave, duke parë shfrytëzimin efikas të kontributeve të tyre jo vetëm në planin kombëtar por dhe në atë rajonal e global.
- Duke konsideruar veten si aktor dhe faktor të përpjekjeve dhe nismave për zhvillimin e sektorit pyjor e kullor, personeli pyjor do të angazhohet në një veprimtari më të përgjegjshme dhe më profesionale.
- Kontribuon në kapërximin e vështirësive që pengojnë sektorin privat në ndërmarrjen e investimeve pozitive dhe nxit ndërmarrjen e sigurte nismave që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, pyjore e kullimore.
- Siguron një kuader legjislativ, vlerësimi e monitorimi që të lejon matjen dhe sipas rrethanave ndryshimin e qeverisjes, bazuar në ecurinë progresive dinamike dhe në arritjen e synimeve politike.

3. PARTNERET INSTITUCIONALE

Institucionet e mëposhtme janë partnerë në zbatimin e Strategjisë së Pyjeve dhe Kullotave. Duke patur parasysh misionin e çdo institucioni, nevojitet që për rolet specifike të institucioneve në marrëdhënie me objektivat strategjike, të arrihet në marrëveshje. Gjithashtu, për zbatimin e strategjisë dhe forcimin e kapacitetit institucional nevojitet të identifikohen edhe burimet e disponueshme.

3.1 Partnerët vendas

- Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
- Ministria e Mjedisit
- Ministria e pushtetit vendor dhe Decentralizimit
- Njesite e Qeverisjes Vendore
- Ministria e Turizmit dhe Rregullimit të Territorit
- Ministria e Ekonomisë
- Ministria e Financave
- Komunitete të interesuara për përdorimin e pyjeve, partner private
- Fakulteti i Shkencave Pyjore – Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Instituti i Kërkimeve të Pyjeve dhe Kullotave
- Shkolla Teknike Pyjore – Shkodër
- Shoqatat jo qeveritare mjedisore

3.2 Partnerët ndërkombëtarë

- Banka Botërore
- Qeveritë e Italisë dhe Zvicrës
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID)
- Organizata Botërore e Bujqësisë dhe Ushqimit (FAO)
- Institucione të tjera që do të kontribuojnë në realizimin e objektivave të kësaj strategjie

4. STRATEGJIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE NE KUADRIN E STRATEGJIVE GLOBALE DHE RAJONALE.

Mbrojtja e burimeve natyrore dhe të natyrës në teresi, ka përbërë prej disa dhjetra vjeçaresh një argument të rëndësishëm për mbarëbotën e qytetëruar.

Kjo dëshnohet me numrin e madh të konventave të nënshkruara nga shumica e shteteve të botës, ndër të cilat edhe Shqipëria. Kështu mund të përmendim Konventën e Diversitetit Biologjik (KDB) të vitit 1994, strategjinë Pan – Europiane të Diversitetit Biologjik dhe të peisazheve (SPEDBP) të cilat bëjnë fjalë për ruajtjen dhe menaxhimin e diversitetit biologjik dhe të resurseve gjenetike. Euromontana e vitit 1998 që përcakton parimet e një politike të qëndrueshme pyjore e kullimore në lidhje të ngushtë me zgjidhjen e kërkesave të popullsisë rurale, Axtenden 2000 e cila jep orientimet baze për një Politikë Bujqësore Komunitare me të blerte etj.

Në hartimin e kësaj strategjie është mbajtur parasysh që idetë e saj të jenë në përshatje me idetë themelore të konventave ndërkombëtare.

5. PERCAKTIMI I PRIORITETEVE.

Pyjet dhe kullotat perbejne nje trashegimi me vlere jo vetem per Shqiperine, por edhe per rajonin e me gjere. Ajo duhet te mbrohet dhe qeveriset ne menyre te tille qe te mundesoje nje zhvillim me te madh ekonomik ne te ardhmen, duke kontribuar ne uljen e nivelit te varferise, pa prishur ekuilibret biologjike natyrore. Ne te kaluaren perfshire dhe vitet e tranzicionit, sidomos pyjet jane vleresuar per rendesine ekonomike, duke nenvleftesuar aspektin shumefunksional te tyre. Vecse shfrytezimi i tyre nuk çon vetem ne fitime por edhe ne humbje (kur nuk shfrytëzohet drejt) si rezultat i humbjes se mundesive per zhvillim ne te ardhmen, rrjedhoje e degradimit e desertifikimit te mjedisit pyjor e kullosor.

Menaxhimi i qendrueshem i resurseve natyrore te pyjeve dhe kullotave nenkupton mireqeverisjen dhe perdorimin e resurseve ne nje menyre dhe me nje ritem qe ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarine, aftesine ripërteritese, vitalitetin dhe potencialin e tyre per te permbushur, per sot dhe te ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale ne nivel lokal, kombetar dhe global, pa shkakuar dëme ne ekosisteme te tjera.

Koncepti i menaxhimit te qendrueshem te burimeve natyrore ne pyje dhe kullota eshte ne thelb i njejte me konceptin e pergjitheshem te te qenurit i qendrueshem. Zhvillimi i qendrueshem eshte ai zhvillim, i cili:

- integron procesin e planifikimit te vlerat ekonomike, mjedisore dhe shoqerore;
- shperndan ne menyre te njejte dhe te barabarte perfitimet qe rrjedhin prej ketij zhvillimi sipas shtresave social-ekonomike dhe gjinise;
- siguron te pakten te njejtat mundesi per nje zhvillim te vazhdueshem edhe per brezat e ardheshem.

Termi "te qenurit i qendrueshem" eshte produkt i iniciativave nderkombetare qe lidhen me Samitin e Tokes (Rio, Qershor1992) dhe Zhvillimin e Qendrueshem ne vijim te tij. Ky term eshte percaktuar dhe shtjelluar me tej nga nje varg procesesh rajonale dhe nderkombetare ne te cilat jane perpunuar kritere dhe indikator te nje zhvillimi dhe menaxhimi te qendrueshem.

Per te realizuar kete koncept, ne stadin aktual kerkohet te mbahen parasysh keto perparesi:

- Nderprerja e biznesit te shfrytezimeve tregetare per nje periudhe te pakten 10 vjeçare nepermjet riorganizimit dhe rritjes se kontrollit. (*Shfrytezimet vazhdojne te kryhen vetem ne ata grumbuj pyjore qe kane te nevojshem trajtimin me prerje per sigurimin e ripërteritjes natyrore.*)
- Vazhdimi i procesit te transferimit te pyjeve dhe kullotave tek organet e qeverisjes vendore drejt kalimit tek komunitetet te te drejtave te plota mbi pronesine.
- Ruajtja dhe rehabilitimi i pyjeve dhe kullotave nepermjet rritjes se investimeve dhe nxitjes se iniciativave private e kolektive.
- Qeverisja e qendrueshme e pyjeve dhe kullotave, nepermjet nje strategjie per nje mbeshtetje te organizuar te produkteve pyjore, ne te gjitha nivelet.

- Vendosja e nje sistemi monitorimi per ndjekjen ne kohe te proceseve dinamike ne pyje dhe kullota dhe per nderhyrjen ne kohe per rehabilitimin e tyre.
- Nxitja e nismave individuale ose kolektive per ripyllimin e tokave te zhveshura dhe te abandonuara.
- Ruajtja, mbrojtja dhe permiresimi i diversitetit biologjik ne ekosistemet pyjore dhe kullosore.
- Ruajtja dhe permiresimi i pershtateshem i funksioneve mbrojtese ne mbareshtimin e pyjeve dhe kullotave (ne menyre te veçante mbrojtjen e tokes, te sasise dhe cilesise se ujrave)
- Ruajtja e funksioneve dhe sherbimeve te tjera social-ekonomike, si dhe sigurimi i perfitimeve te shumefishta per shoqerine, per brezat e sotem dhe te ardheshem.

Zbatimi i nje sere konventash nderkombetare me objektiva ne mireperdorimin dhe ruajtjen e pyjeve e kullotave mund te arrihen vetem nepermjet pranimit dhe respektimit te parimeve te ruajtjes dhe zhvillimit te praktikave te nje zhvillimi te qendrueshem te gjithe sektoreve qe lidhen me to.

6. PARIME STRATEGJIKE

6.1 Qeverisja e qendrueshme e burimeve pyjore e kullosore.

Kjo buron nga:

- nevoja e nje vleresimi me te mire te burimeve pyjore e kullosore ne aspektin shumefunksional,
- nevoja e rritjes se shtresave te popullsisë te interesuara per mirembajtjen e mireqeverisjen e pyjeve dhe kullotave,
- nevoja e nje lufte me efikase ne drejtim te uljes se shkalles se erozionit dhe desertifikimit,
- nevoja e ruajtjes dhe perdorimit efikas te burimeve ujore.

6.2 Ndarja e drejte e perfitimeve dhe dobive qe vijne nga mbrojtja dhe perdorimi i burimeve natyrore, pyjore e kullosore.

Kjo buron nga:

- nevoja e rritjes se numrit te familjeve qe perfitojne nga te ardhurat pyjore e kullosore me qellim luftimin e nivelit te varferise,
- nevoja e decentralizimit te kontrollit mbi pyjet dhe kullotat deri ne nivel komune, fisi e familje,
- nevoja e perdorimit, e ruajtjes se traditave, e kultures ne drejtim te mireadministrimit te pyjeve,
- nevoja e ndryshimit te struktures se pyjeve e kullotave lidhur me pronesine, drejt niveleve te vendeve te tjera te perparuara,
- nevoja e lenies si trashegimi per brezat e ardhshem te nje ekonomie pyjore e kullosore vitale e te shendetshme.

6.3 Rimekembja e integritetit ekologjik te pyjeve e kullotave ne vend.

Kjo buron nga:

- domosdoshmeria e mbeshtetjes se konceptit te pergjithshem mbi ruajtjen e pasurive natyrore ne perputhje me angazhimet e marra ne nivel nderkombetar, veçanerisht permes antaresise ne Konferencen Ministeriale per Mbrojtjen e Pyjeve ne Europe, pa neglizhuar konventa te tjera qe operojne ne fushen e pyjeve e kullotave.

7. QELLIMET E DEKLARATES MINISTRORE.

Ne deklaraten ministrore per rishikimin e Strategjise se Sektorit te Pyjeve dhe Kullotave dalin ne pah dy qellime kryesore:

- Te sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e integritetit te kesaj pasurie natyrore te qendrueshme, e ne kete kuader edhe biodiversitetit pyjor dhe kullosor;
- Ekonomia pyjore te kontribuoi ne zbutjen e varferise ne zonat rurale.

Gjithashtu deklarata ministrore konfirmon prioritetet e qeverise Shqiptare per konservimin e pyjeve. Ne deklarate ofrohen direktiva te veçanta ne mbeshtetje te zhvillimit te sektorit te pyjeve dhe reformes se tij, ku mund te permendim:

- Nje nxitje te menaxhimit te pyjeve dhe kullotave drejt konservimit natyror, mirembajtjes se biodiversitetit dhe zhvillimit te eko-turizmit;
- Rehabilitimi i pyjeve te degraduar per t'i rikthyer ne kushte optimale te stacionit pyjor perkates;
- Ripercaktimi i drejtimeve te punes sipas koncepteve afat-gjate te zhvillimit per administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave;
- Formulimi i nje Programi Kombetar te Pyjeve dhe Kullotave (Program 10 vjeçar);
- Vazhdimi i transferimit te pyjeve dhe kullotave tek njesite e qeverisjes vendore, proces i cili rrit rolin e Pushtetit Vendor ne planifikimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore pyjore dhe kullosore;
- Krijimi i mundesive perfituese ne mbrojtjen, konservimin dhe permiresimin e burimeve pyjore dhe kullosore edhe permes programeve qeveritare;
- Vazhdimi i bashkepunimit teknik dhe financiar me agjensite nderkombetare ne sektorin e pyjeve dhe kullotave per te siguruar burime te investimeve;
- Ngritja e kapaciteteve drejtuese dhe menaxhuese ne nivelin e njesive te qeverisjes vendore dhe partenereve private, si dhe zhvillimi i nje programi efektiv te kstensionit pyjor;
- Nxitja e perfitimi i te ardhurave permes zhvillimit te mundesive rikrijuese dhe turizmit;
- Percaktimi i roleve dhe funksioneve te gjithe aktoreve ne sektorin e pyjeve dhe kullotave dhe identifikimin e lidhjeve me kritike mes tyre;
- Permiresime te struktures ligjore te sektorit te pyjeve dhe kullotave dhe formulimi i nje ligji te ri per pyjet dhe kullotat;
- Perfundimi i procesit te reformes brenda vitit 2012.

8. SYNIMET STRATEGJIKE

Synimi I. Sigurimi i integritetit territorial, ekologjik dhe biodiversitetit të pyjeve dhe kullotave

Drejtimi strategjik. Mbrojtja e pyjeve përmes ndalimit të shfrytëzimit, kombinuar me marrjen e masave për restaurimin, ruajtjen dhe përmirësimin e biodiversitetit (ruajtja e pyjeve dhe tokave pyjore, përmirësimi i funksioneve për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe të ujërave, nderhyrjet përmirësuese në kullota).

Objektivi 1. *Konservimi i pyjeve nëpërmjet nderprerjes së prerjeve tregtare me qëllim fitimi dhe prerjeve ilegale pa përjashtuar prerjet kulturore të të gjitha llojeve.*

Veprimet:

- Nderprerja e shfrytëzimeve tregtare për 10 vjet.
- Ulja sa të jete e mundur me shume e nivelit të prerjeve ilegale.
- Ruajtja e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër duke kaluar në konservimin e plote të tyre.

Objektivi 2. *Ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve pyjore e kullosore të demtuara e në degradim (ruajtja e specieve autoktone).*

Veprimet:

- Organizimi i punës nga DSHP në mënyrë të tillë që e gjithë sipërfaqja e pyjeve të lartë të përshkohet nga prerje kulturore sipas fazës së zhvillimit në të cilën gjendet dhe kërkesave të silvikultures për fazën përkatëse.
- Gjetja e sponsorëve për ripulëzimin e sipërfaqeve të pa ripërteritura brenda pyjeve të lartë me qëllim përdorimin e gjithë sipërfaqes nga pylli prodhues.
- Gjetja e sponsorëve dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të çveshura me lloje pionere për të rritur kapacitetin e sekuestrimit të karbonit nga sipërfaqja e territorit të republikës.
- Rehabilitimi i kullotave me mbjellje foragjere e drusore sipas shkallës së pjellorise në të cilën gjenden.

Objektivi 3. *Krijimi i disa ekonomive shtetërore me cungishte të rregullta lisi dhe mbarështrimi i tyre shkencor bazë për ruajtjen e llojeve të vlefshme të dushqeve dhe konvertimin e tyre në pyje të lartë. (Brenda limitit të pyjeve të tillë që i mbeten shtetit)*

Veprimet:

- Përzgjedhja e sipërfaqeve me dushqe me madhësi dhe përbërje llojore të duhur të përshatëshme për shndrimin e tyre në cungishte të rregullta.
- Hartimi i projekteve teknik të ekonomive dhe fillimi i zbatimit të tyre.
- Llogaritja e mundësisë vjetore aktuale dhe të perspektivës (kur ekonomitë të jenë përbërë plotësisht nga cungishte të rregullta) dhe kryerja e studimit për konverzonin e këtyre ekonomive.

Drejtimi strategjik. Organizimi i një kadastrë pyjore moderne si bazë për ruajtjen e tërësisë së fondit pyjor.

Objektivi 1. *Perfundimi dhe me vonë implementimi me sukses i te dhenave te Inventarit Kombetar te Pyjeve.*

Veprimet:

- Azhornimi i kadastrës pyjore me te dhenat e Inventarit Kombetar te Pyjeve dhe kullotave te perfunduar.
- Perfundimi i punimeve te tjera sekondare qe shoqerojne Inventarizimin kombetar te pyjeve dhe kullotave (tabelat e kubaturave etj.).
- Kalimi i infrastruktures se inventarizimit ne kompetencat e kadastrës pyjore.

Objektivi 2 *Organizimi i nje kadastrë pyjore moderne.*

Veprimet:

- Të përgatitet e miratohet një vendim për riorganizimin e kadastrës pyjore mbi baza bashkëkohore e cila të dokumentoj e azhurnoj pasurinë pyjore jo vetëm si sipërfaqe e volum por edhe si vlerë e pronësi në të gjitha nivelet e administrimit.
- Duke qënë një aktivitet i përhershëm, kadastra pyjore të kryhet nga një njësi e specializuar në nje ambient te veçante por ne vartësi direkte nga DPPK.
- Të paset sektori i kadastrës me të gjithë teknikën moderne të fushës si GIS etj.
- Të shihet mundësia për futjen e nje lënde për kadastrën pyjore në programet e Fakultetit të Pyjeve.

Drejtimi strategjik. *Permirosimi i menaxhimit te zonave te mbrojtura*

Objektivi 1. *Menaxhimi efektiv i Zonave te Mbrojtura egzistuese dhe pergatitja e kushteve për zgjerimin gradual te tyre, sipas propozimeve te strategjise dhe planit te verpimit te biodiversitetit per krijimin e PEN.*

Veprimet:

- Miratimi i Rrjetit Përfaqësues të Zonave të Mbrojtura (RrPZM) i cili mbulon rreth 14% të territorit të vendit. Të hartohet një projekt-plan, i cili të përfshijë parashikime buxhetore për menaxhimin efektiv dhe zhvillimin eventual të sistemit të zonave të mbrojtura, duke identifikuar zonat me prioritet më të lartë dhe kriteret për klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, me qëllim që të tërhiqet vëmendja për gjendjen, si dhe të përcaktohen hapat dhe afatet për realizimin e tij.
- Përgatitja e planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura me perparësi ne ato më të ndjeshme dhe të rëndësishme (psh., Parqet Kombëtare)
- Të fillojë zbatimi i mbarështimit të parqeve dhe zonave të mbrojtura, sipas planeve të hartuara për to.
- Të vlerësohen efektet e zbatimit të planeve të mbarështimit.
- Të rivlerësohet sistemi i lejeve dhe tarifave për parqet kombëtare dhe të ndiqet e kontrollohet zbatimi i tyre.
- Të kërkohet mbështetja e Organizatave dhe Organizmave Ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës (p.sh., Fondi Botëror për Ruajtjen e Jetës së Egër--WWF, Unioni për Ruajtjen e Natyrës—IUCN, Fondi i Ndihmave Globale per

Mjedisin- (GEF), etj) për të zhvilluar plane të ruajtjes së biodiversitetit dhe për t'i zbatuar ato në zonat e rëndësisë së veçantë.

- Përgatitja dhe zbatimi i planeve të veprimit të llojeve dhe habitateve.
- Zbatimi i një programi në shkallë të gjerë për ruajtjen dhe përmirësimin e diversitetit biologjik e pejsazhistik, me theksim mbi përgjegjësitë në nivel vendor.
- Zhvillimi i një plani kombëtar për ngritjen e rrjetit ekologjik – bioqendrat, biokorridorët, zonat e rehabilitimit dhe zonat buferike.
- Përgatitja dhe zhvillimi i projekteve pilot për ruajtjen dhe përmirësimin e diversitetit biologjik dhe pejsazhor.
- Të përcaktohen shenjat dalluese për të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura.
- Zgjerimi i RrPZM për të mbuluar deri në 25% të territorit të vendit. Hapi i dytë për ngritjen e Rrjetit Ekologjik pas miratimit dhe ngritjes së RrPZM-ve është ai i krijimit të biokorridorëve për të lidhur ZM-të me njëra tjetrën. Një proces i tillë do të kërkonte që brenda vitit 2020 rrjeti i ZM-ve të mbulojë rreth 25% të territorit të vendit, gjë që përbën dhe objektivin e largët të SPVB-së.

Objektivi 2. Ngritja e administratave të zonave të mbrojtura dhe trajnimi i tyre, me përparesi në parqet kombëtare dhe zonat natyrore të menaxhuara si dhe pejsazheve të mbrojtura, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të ZM-ve përmes një pjesëmarrje sa më të gjere të komuniteteve vendase në to.

Veprimet:

- Të vlersohen infrastruktura, pajisjet, materialet, personeli dhe nevojat financiare dhe ato për kualifikim e trajnim të nevojshme për të arritur një nivel optimal për ruajtjen e zonave të mbrojtura të konsideruara si prioritare.
- Ngritja sa më shpejte e administratave dhe autoriteteve menaxhuese të zonave të mbrojtura.
- Të hartohen dhe zbatohen programe për organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit në nivel kombëtar dhe në rrethet ku ka zona të mbrojtura, për të informuar publikun për rëndësinë, vlerat dhe dobitë e këtyre zonave.
- Të programohen dhe zbatohen kurse kualifikimi special për personelin e DPPK dhe të DSHP-ve që do të ngarkohen për të kontrolluar dhe mbrojtur dhe menaxhuar këto zona.
- Të nisë procesi i zgjidhjes së çështjeve të pronësisë në zonat e mbrojtura, të cilat duhet të shqyrtohen rast pas rasti me përfshirjen e autoriteteve vendore dhe personave të interesuar.
- Të shfrytëzohet mbështetja e organizatave jo-fitimpruresë që kanë interes për zonat e mbrojtura dhe të vendosen marrëdhënie të duhura pune me to në fushat e rritjes së ndërgjegjësimit publik, edukimit për mjedisin, dhe shërbime vullnetare jo-teknike (fushata kundër ndotjes dhe studime ekologjike)
- Zbatimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura.

Drejtimi strategjik. Ruajtja e natyres dhe promovimi i ekoturizmit.

Objektivi 1. Hartimi i nje plani kombetar, rajonal dhe vendor per zhvillimin e turizmit ne pyje e kullota si dhe ne disa kategori zonash te mbrojtura dhe fillimi i zbatimit te tij.

Veprimet:

- Te krijohet nje grup pune me përfaqësues të DPPK, të Ministrise se Puneve Publike dhe Turizmit, Ministrine e Mjedisit, KRT, REC, Ministrise se Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe OJQ-te për të hartuar një plan kombëtar për zhvillimin e turizmit në pyje e kullota. Ky plan duhet te perfshije zhvillimin e turizmit edhe ne disa kategori zonash të mbrojtura, ku sipas ligjit lejohet zhvillimi i aktiviteteve shlodhese dhe rekreative, si parqet kombetare (kategoria II), zonat e pejsazheve te mbrojtura (kategoria V) dhe zonat e resurseve te menaxhuara (kategoria VI e ZM-ve).
- Te behet ne menyre me profesionale puna per promovimin e turizmit dhe ekoturizmit brenda dhe ne afersi te zonave te mbrojtura, si nje burim i rendesishem i sigurimit te te ardhurave per komunitetet qe jetojne prane ose brenda zonave te mbrojtura.
- Te vendosen kontakte me te mira pune dhe bashkpunimi me agjensite vendase dhe te huaja turistike qe operojne ne vendin tone, per promovimin e ekoturizmit ne zonat natyrore pyjore te vendit tone, sidomos ne parqet tona kombetare.

Objektivi 2. Pjesmarrja e qeverise per mbeshtetjen dhe zhvillimin e infrastruktures, kreditimit dhe turizmit privat.

Veprimet:

- Të hartohet një model për dhënien e konçesioneve sipërmarrësve të sektorit privat që janë të interesuar të sigurojnë shërbime turistike, çlodhëse dhe argëtuese në natyrë.
- Qeveria te shohe me perparesi permiresimin dhe zhvillimin e infrastruktures ne zonat me perparesi turizmin, pa te cilen s'mund te kete zhvillim te asnje alternative turizmi. Ne kete kendveshtrim ajo duhet te nxise spermarrjen private për te investuar ne fushen e turizmit, perfshire turizmin malor aplin per te cilin Shqiperia ka potenciale te mëdha.
- Qeveria te nxise dhe inkurajoje sektorin bankar per te ndihmuar permes sistemit te kredive lehtesuese zhvillimin e turizmit familjar ne zonat rurale prane zonave te mbrojtura, me potenciale te medha per zhvillimin e turizmit malor.
- Trainimi i guidave turistike
- Ngritja e qendrave te informimit per zonat e mbrojtura

Synimi II. Nxitja dhe Mbeshtetja e Menaxhimit te Qendrushme te Burimeve Pyjore dhe Kullosore

Drejtimi strategjik. Permiresimi i organizimit e procesit të prodhimit pyjor për pyjet e lartë.

Objektivi 1. Formimi i njesive te reja te prodhimit per pyjet e larte prodhues.

Veprimet:

- Organizimi i masiveve pyjore shtetërore me pyje të lartë në njësi prodhimi me synimin sigurimin nga sejcila prej tyre të vazhdimësisë të procesit të prodhimit pyjor ne nivel rajoni.
- Hartimi i planeve të mbareshtimit të këtyre njësive të prodhimit dhe rimbareshtimi i tyre çdo dhjetë vjet duke parashikuar shfrytëzimet të pakten për një periudhë 20-40 vjeçare mbi bazën e parimit të vazhdimësisë.

Objektivi 2. Krijimi i Drejtorive Pyjore Rajonale**Veprimet:**

- Bashkimi i këtyre njësive të prodhimit në disa drejtori pyjore menaxhuese rajonale, me varesi direkte nga DPPK(pas vitit 2009)
- Vjelja e produkteve pyjore të njësive të prodhimit nga firmat private, për llogari të drejtorive të cilat paguajnë firmat për punën e kryer por ndermarjet mbeten zoterues të produkteve (per lenden ankand ne ane te rruges).

Drejtim strategjik. Ndryshime të kuadrit administrativ e ligjor për mbareshtimin e pyjeve të lartë prodhues.**Objektivi 1. Organizimi i një njesie kombëtare të mbarështrimit dhe projektiveve pyjore me varësi direkte nga DPPK.****Veprimet:**

- Prgatitja e ligjit përkatës për themelimin e kësaj njesie dhe gjetja e mundësive materjale duke rivlerësuar të gjitha burimet.
- Hartimi të planeve të mbarështrimit të pyjeve prodhues, të pyjeve komunalë, kullotave si dhe të pyjeve private në funksion të pageses, që mund të jete e njejte per njesi siperfaqe me ate te pyjeve shteteror.(Aktivitet i perhershëm)
- Inventarizim kombëtar të pyjeve dhe kullotave. (Aktivitetin periodik)
- Pasqyrim i ndryshimeve në kadastrën pyjore. (Aktivitetin e përhershëm)
- Hartimin e projekteve të fushave të ndryshme të pyjeve (sipas gjëndjes së investimeve që jepen) me specialistët e vet ose të jashtëm të angazhuar me kontratë.

Drejtimi strategjik. Mbeshtetje e kërkimit shkencor në funksion të mbarështrimit të pyjeve.**Objektivi 1. Ripunimi i udhëzuesëve dhe rregulloreve****Veprimet:**

- Ripunimi i udhëzuesit aktual të mbarështrimit të pyjeve me synimin për ta bërë atë më të kuptueshëm e më të lehtë për zbatim.
- Hartimi i një udhëzuesi për mbarështrimin e pyjeve e kullotave të destinuara për përdorim (shfrytëzim) silvopastoral.

Objektivi 2. *Plotesimi i games se tabelave dendrometrike dhe rritja e nivelit te teknikes llogaritese ne mbareshtim.*

Veprimet:

- Plotësimi i gamës te tabelave të prodhimit për llojet qe nuk i kane ato dhe rishikimi i tabelave ekzistuese. Fillimi i ndërtimit të tabelave të prodhimit në funksjon të intesiteteve të ndryshme të rallimeve të aplikuara.
- Plotësimi i gamës së tabelave të kubaturës qe mungojne për lloje të tjera.
- Futja e teknikave moderne në të gjitha hallkat e procesit të mbarështimit të pyjeve (GIS, GPS, programe kompjuterike, etj.).

Objektivi 3. *Rritja e nivelit shkencor te profilit*

Veprimet :

- Të rritet niveli i Buletinit Informativ të DPPK, duke e shnderuar atë në një organ jo vetëm informues por edhe shkencor me redaksi që të respektoj të gjitha regullat, me peshë shkencore, unik në shkallë vëndi.
- Të studjohet mundësia e mbeshtetjes së punes kerkimore - shkencore, si dhe bashkerendimi i forcave shkencore, mjeteve dhe fondeve sepse për një vënd të vogël si Shqipëria ato kanë qënë dhe do të mbeten gjithmonë të pa mjaftushme. Reflektimi në programet mësimore e shkencore të Fakultetit dhe IKPK të të gjitha zhvillimeve të reja.
- Fakulteti i Shkencave Pyjore te adresoj drejtimet e diplomimit te studenteve ne perputhje me mundesine e punesimit te tyre ne sherbimin pyjor.

Drejtimi strategjik. *Nxitja e perdorimit multifunksional te burimeve pyjore dhe kullosore.*

Objektivi 1. *Promovimi i funksioneve sociale dhe mbrojtese te pyjeve.*

Veprimet:

- Promovimi i funksionit social te pyjeve dhe kullotave lidhur me mbrojtjen e shendetit publik, mbrojtjen e ujrave, tokes dhe ajrit.
- Promovimi i funksioneve mbrojtese te pyjeve dhe kullotave nga erozioni dhe rreshqitja e tokes, orteqet, ererat dhe permybtjet.
- Rritjes se efekteve mbrojtese te pyjeve nga ndotjet e tokes, ajrit dhe ujrave.
- Promovimi i efektit mbrojtës te pyjeve per qendrat e banuara, infrastrukturave te transportit, energjise dhe furnizimit me uje, monumenteve natyrore, kulturore dhe arkeologjike.
- Promovimi i vlerave çlodhese dhe rekreative.

Objektivi 2. *Promovimi i potencialit prodhues per prodhimet jo drusore.*

Veprimet:

- Studimi dhe promovimi i potencialeve prodhuese te pyjeve dhe kullotave ne bime mjeksore dhe tanifere.
- Studimi i popullatave te kafsheve te egra objekt gjuetije per promovimin e nje gjuetije racionale per qellime sportive dhe turistike.
- Studimi i mundesive te peshkimit ne ujrat brenda fondit pyjore.

- Studimi i mundësive mbajtëse të fondit pyjorë dhe kullësorë për nxitjen dhe zhvillimin e sektorit të bletarisë.

Drejtimi strategjik. Përdorimi i qëndrueshëm i masiveve kullësore shtetërore.

Objektivi 1. Studimi dhe përcaktimi i gjendjes, sistemeve të përdorimit, administrimit e qëndrueshëm të integruar e multifunksional të kullotave.

Veprimet:

- Studimi i gjendjes dhe kapaciteteve mbajtëse të masiveve kullësore publike dhe komunale, pa cenuar nevojat e kafsheve të egra barngrënëse.
- Studimi dhe përcaktimi i sistemeve të përdorimit të kullotave natyrore dhe mbi këto baze i mënyrës së qeverisjes.
- Krijimi dhe forcimi në kuadrin e shërbimit pyjor (Drejtoria e Menaxhimit) të sektoreve të posaçme për administrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të kullotave.
- Administrimi i specializuar, i qëndrueshëm e shumëfunksional nga ana e shërbimit pyjor të kullotave.
- Qeverisja e qëndrueshme, e integruar dhe shumëfunksionale e tyre mbi bazën e një plani qeverisjeje, sipas udhëzësve të hartuar nga specialistë dhe të miratuar nga DPPK.
- Evidentimi dhe vlerësimi i të gjitha prodhimeve (biomasa, bimë medicinale, gjah, eko-turizëm etj) e të ardhurave që vijnë nga përdorimi shumëfunksional.
- Ndalimi i aktivitetit tradicional të djegjes së kullotave me piksynim “rigjallërimin” e bimesisë barishtore.

Objektivi 2. Organizimi i punës për administrimin dhe vlerësimin racional të kullotave.

Veprimet:

- Rishikim e përcaktimi i tarifave të diferencuara sipas zonave, vlerave ekonomike e gjendjes vegjetacionale.
- Sigurimi i vendeve të punës për popullsinë e vendosur në afërsi të këtyre kullotave.
- Stimulimi i iniciativave kolektive apo individuale për përmirësimin e gjendjes së kullotave.
- Rritja e investimeve për përmirësimin e gjendjes ekologjike dhe prodhues të kullotave.
- Ndarja e masiveve të mëdha kullësore të shtetit në ekonomi të mëdha (500-1000 hektarëshe) dhe dhënia e tyre në përdorim privatë për periudha të gjata kohe. (të paktën 30 vjet-me synim privatizimin e plotë).

Synimi III. Përsosja dhe forcimi i lidhjeve me ekonominë e tregut

Drejtimi strategjik. Inkurajimi i aktiviteteve private

Objektivi 1. Kryerja e punimeve dhe sherbimeve ne pyje e kullota shteterore.

Veprimet:

- Terheqja e firmave private te specializuara, për kryerjen e aktiviteteve prodhuese dhe sherbimeve ne pyje dhe kullota.
- Të liberalizohen tarifat e shitjes së lëndës industriale të drurit dhe te druve te zjarrit që rezultojne nga pyjet prodhues shteterore. Ato t'i binden ligjeve të kërkesë-ofertës. Lënda e drurit të shitet në skelë (ose pikë tranziti) me ankand ne ane te rruges, ose te studjohen format e koncensionit ne pyje.
- Dhenia e kredive te buta dhe masa te tjera nxitese per mbeshtetjen e aktiviteteve dhe sherbimeve ne pyje dhe kullota.
- Nxitja e nismave qe sigurojne burime alternative per ngrohje dhe gatim ne zonat rurale si dhe ato qe sigurojne vende pune jashte sektorit te pyjeve kullotave.
- Vjelja e nje takse per sherbimin qe pyjet kryejne ne mbrojtje te baseneve ujembledhese te hidrocentraleve dhe ujit te pijshem per luften kunder erozionit dhe permiresimin e pyjeve ekzistues.

Objektivi 2. Nxitja e krijimit te njësive prodhuese 500-1000 hektarëshe në sipërfaqe pyjesh të ulët e shkurresh, me prodhimtari të mirë biomase duke i dhene ne perdorim afatgjate sipas kërkesave të ekonomisë së tregut pjesët më të mira të këtyre sipërfaqeve per perdorim silvopastoral.

Veprimet :

- Studim mbi përcaktimin e mundësive që egzistojnë në këtë drejtim duke patur parasysh atë pjesë të sipërfaqes pyjore të dushqeve e shkurreve që do te mbetet e shtetit.
- Prgatitja e kuadrit ligjor.
- Hartimi i planeve të mbarështrimit të këtyre njësive private silvo pastorale.

Objektivi 3. Zhvillimi ne perspektive i industrisë së drurit në Shqipëri.

Veprimet :

- Çertifikimi i grumbujve pyjore prodhues sipas klasave të moshës dhe cilësisë së lëndës, kryesisht grumbujt me lende te vlefshme per industrine.
- Studim mbi përcaktimin i mundësisë vjetore në sasi lloje dhe asortimente dhe sigurimi i saj për 20-40 vjetët e ardhshëm.
- Te aplikohen politika favorizuese per importimin e lendes drusore per mbeshtetjen e zhvillimit te industrise se drurit ne vendin tone dhe njekohesishte konservimin e pyjeve tane.
- Mbi këtë bazë llogaritja dhe nxitja e zhvillimit të insustrisë së drurit si aktivitet privat në ato drejtime që e lejon ekonomia e tregut sidomos ne zonat rurale .

Objektivi 4. Dhënia në përdorim e tokave me bimesi pyjore, pyje të degraduar, për afate të gjata kohe (p.sh. 30 vjet) për qëllim ngritje rezervatesh gjuetie, qëndra të rritjes së kafshëve të egra ose kombinim i

tyre, personave dhe shoqërive private të vëndit ose të huaja, për vlerësimin e këtyre terreneve marginale dhe zënien me punë.

Veprimet :

- Thithja e investimeve nga buxheti i shtetit dhe donatore të tjere.
- Shtimi i fondit të ri-investimit nga të ardhurat e vet DPPK.
- Caktimi i sipërfaqeve boshe e me pyje të degraduara, etj. për ngritjen e rezervateve të gjuetisë, pa prekur interesat e të tjerëve.
- Dhënia në përdorim afatgjatë e në perspektivë në pronësi i këtyre sipërfaqeve personave ose shoqërive private të vëndit apo të huaja
- Dhënia në përdorim (ose shitja) e qëndrave egzistuese (tashmë të shkatëruara) të rritjes së fazanëve për qëllime ripopullimi, konsumi dhe eksporti.
- Përgatitja e kuadrit ligjor për këto kalime.

Objektivi 5. Dhënia në përdorim vetëm për qëllime pyllëzimi të tokave të refuzuara dhe të eroduara (për periudha të gjata kohe (p.sh. 50 vjet) ose në pronësi (me çmime modeste) i sipërfaqeve që në bilancin e përgjithshëm të republikës emërtohen-toka të tjera-(e që rezultojnë pasi zbriten pyjet, kullotat, dhe tokat bujqësore) të cilat duhet të mbillen brenda limitesh kohore të caktuara, personave apo shoqërive private të vëndit ose të huaja.

Veprimet :

- Caktim i sipërfaqeve që mund të trajtohen si të tilla pa prekur interesat e komunave për kullotë.
- Përgatitja e kuadrit ligjor për këtë lloj përdorimi afatgjatë me synimin e largët të privatizimit të plotë.
- Dhënia në përdorim e këtyre sipërfaqeve dhe kontrolli i zbatimit të qëllimit për të cilin janë dhënë.
- Nxitja e nismave individuale ose kolektive për ripylyezimin e tokave të abandonuara, veçanërisht atyre të shpyllezuara ose kullotave të pluguara në të kaluarën.(Të kthyer në tokë)
- Nxitja e nismave individuale e kolektive që kanë si qëllim uljen e nivelit të erozionit i cili në shkallë të gjere kërcënon të ardhmen e komuniteteve malore dhe i shkakton një dem shumë të madh cilesise se ujit të rezervuarve infrastruktures se ujitjes si dhe ndotjes se tokave bujqësore të ultesires.

Synimi IV. Përfshirja e aktoreve dhe përdoruesve lokal në ruajtjen dhe zhvillimin e pylltarisë.

Drejtimi strategjik. Vazhdimi i transferimit të së drejtës së përdorimit/pronesisë të pyjeve dhe kullotave tek pushteti vendor për plotësimin e nevojave për dru zjarri e kullote.

Objektivi 1. Vazhdimi i transferimit të së drejtës së përdorimit/pronesisë të pyjeve dhe kullotave tek pushteti vendor, duke rritur numrin e familjeve që përfitojnë nga produktet e pyllit.

Veprimet:

- Përfundimi i kalimit të 40 % të fondit pyjor në përdorim/administrim të komunave.
- Krijimi i strukturave menaxhuese të pyjeve dhe kullotave në komuna.

Objektivi 2. Plotësimi i nevojave të popullsisë rurale me dru zjari e lëndë ndërtimi.

Veprimet:

- Në bazë të politikës demografike të shtetit, Pushteti vendor dhe DPPK të përcaktojnë dinamikën e nevojave për dru zjari e lëndë ndërtimi për zonat rurale si dhe mënyrën e plotësimit të tyre.
- Depistimi i potencialit të pyjeve komunale prodhuese për dru zjari dhe lëndë ndërtimi.
- Krijimi i cungishteve të rregullta brenda territoreve të pyjeve komunalë me madhësi të tillë që të plotësojnë nevojat e komunave për dru zjari e lëndë ndërtimi dhe bashkimi i tyre në ekonomi pyjore cungishtesh të rregullta përmbledhëse për qëllime mbarështrimi me turne të shkurtëra.
- Hartimi i planeve të mbarështrimit të ekonomive përbashkëta komunale në hapësirën e një ose më shumë komunave dhe zbatimi i tyre nga ana e administratës së komunave.
- Nxitjes së nismave që sigurojnë burime alternative për ngrohje dhe gatim në zonat rurale si dhe ato që sigurojnë vende pune jashtë sektorit të pyjeve kullotave.

Objektivi 3. Përcaktimi i kapacitetit mbajtës në blegtori i pyjeve komunalë (300.000 ha) dhe organizimi i ekonomive pyjore për qëllime kullotjeje dhe prodhim gjethi.

Veprimet:

- Pas veçimit të pyjeve për prodhim dru zjari e lëndë ndërtimi (cungishte të rregullta) ndarja e fondit që mbetet (pyjor ose edhe kullësor të komunave së bashku) në ekonomi silvopastorale me bazë komune, fisi, familjesh etj.
- Mbarështrimi i këtyre ekonomive për qëllime kullotjeje mbi bazën e përcaktimit të potencialit prodhues në biomasë të gjelbërt dhe llogaritja mbi këtë bazë e kapacitetit mbajtës të tyre.
- Administrimi dhe planifikimi i prodhimit dhe kullotjes nga administrata e komunave (ose nga fiset, familjet).
- Nxjerja e rregulloreve të mbështetura shkencërisht dhe ligjërisht për trajtimin dhe qeverisjen e pyjeve komunale.

Drejtimi strategjik. Organizimi i shërbimit këshillimor dhe administratës pyjore të komunave.

Objektivi 1. Zhvillimi i programeve te sherbimit keshillimor dhe te ngritjes se kapaciteteve, permes te kuptuarit te vlerave komplekse te pyjeve dhe kullotave, zhvillimit te programeve te ndergjegjesimit per aktoret dhe komunitetet lokale, dhe forcimit te kapaciteteve te organeve vendore per menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

Veprimet:

- Organizimi i struktures se sherbimit keshillimor pyjor veçanerisht per pylltarine komunale dhe private.
- Planifikimi i nje sasive fondesh (200.000 – 500.000 leke/vit) per kualifikimin e punonjesve te sherbimit pyjor, veçanerisht per personelin qe kryen funksione keshillimore.

Objektivi 2. Krijimi i administrates se pyjeve komunale.

Veprimet :

- Krijimi në çdo komunë i një njësie të vogël tekniko-administrative që do të merret me administrimin dhe regullimin e shfrytëzimit të pyjeve dhe kullotave të dhëna në përdorim, me vartësi direkte nga komuna, mbi të cilat DPPK të ketë të drejtën e kontrollit dhe mbështetjes teknike.
- Nxjerja e rregulloreve për funksjonimin e këtyre njësive duke përcaktuar statusin, sferën e veprimtarisë, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat.
- Planifikimi dhe qeverisja e territoreve si nje e tere, nepermjet organizimit, trajnimit, edukimit dhe sensibilizimit te gjithe aktoreve.
- Ndermarrja e politikave te kompensimit te veshtiresive ekonomike qe rrjedhin nga sakrificat kufizuese ne perdorimin e pyjeve dhe kullotave, ne bashkepunim te ngushte me pushtetin vendor dhe donatoret nderkombetare, me qellim krijimin e mundesive te fitimit per komunitetet e prekura.

Synimi V. Reforma institucionale dhe ligjore e sherbimit pyjor ne nivel kombetar dhe lokal.

Drejtimi strategjik. Vazhdimi i reformes institucionale me qellim krijimin e strukturave sa me efektive dhe te pershtateshme ne qender dhe ne baze.

Reforma dhe forcimi institucional perben nje faktor shume te rendesishem per garantimin dhe venien ne jete te Strategjise se Zhvillimit te Sektorit Pyjor e Kullosor dhe sigurimin e vazhdueshmerise se ketij procesi. Vetem duke plotesuar e permiresuar kuadrin ligjor duke reformuar dhe ngritur institucione te pershtateshme dhe te pergjegjeshme, te afta per te drejtuar e kontrolluar zbatimin e ligjit dhe programet e zhvillimit, mund te jemi optimiste per te ardhmen.

Objektivi 1. Fuqizimi i institucioneve pergjegjese shteterore.

Veprimet:

- Thjeshtesimi dhe forcimi i strukture organike te DPPK si organ qendror i hartimit te strategjise se zhvillimit te sektorit te pyjeve dhe kullotave, ne perputhje me politikat e qeverise, si dhe kontrollit te zbatimit te saj.
- Krijimi i strukturave nderdikasteriale qe te vleresojne projektet dhe programet e zhvillimit per nje planifikim me te mire te territorit.
- Krijimi pranë DPPK i një këshilli (teknik apo shkencor) ku përveç përfaqësuesve të saj të marin pjesë edhe specialistët më të kualifikuar e më me përvojë të fushës pavarësisht se ku punojnë, në se punojnë dhe me se meren. Këshilli të ketë status konsultativ për DPPK ne probleme teknike dhe strategjike.
- Krijimi i nje strukture policore te zhdervjellte me status te veçante, i cili t'i jap mundesi per mbrojtjen e integritetit territorial te mjedisit pyjor dhe kullor si dhe pasurise se tij duke bere kontrolle deri ne produktet e gateshme.
- Forcimi i lidhjeve te shendosha me institucionet arsimore dhe kerkimore – shkencore te fushes se pyjeve.

Objektivi 2. Ndarja e funksioneve kontrolluese nga ato menaxhuese ne pyje dhe kullota

Organizimi i DPPK si sherbim dhe polici pyjore se bashku nuk ka dhene frutet e duhura. Riorganizimi i DPPK si nje institucion ku te kete ndarje te qarta te funksioneve menaxhuese nga ato kontrolluese dhe perkatesisht Drejtorite e Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave qe kane si qellim kryerjen e detyrave te sherbimeve pyjore dhe atyre keshillmore, duke inkurajuar partnershipin me aktoret e interesuar dhe delegim te pergjegjesive te qeverisjes tek qeverisja vendore, do influenconte pozitivisht ne permiresimin, ruajtjen dhe mireadministrimin e pasurise pyjore e kullosore. Ndersa Drejtoria e Policise Pyjore ka per detyre kontrollin e zbatimit te ligjshmerise pyjore ne perputhje me statusin e percaktuar.

Per nje periudhe tranzitore, te nevojshme per konsolidimin e gjithanshem te tyre, perfshire ate financiar, te trija strukturat te varen nga nje Drejtor i Pergjithshem i Pyjeve dhe Kullotave, i cili, nga ana e tij, varet nga Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit. Kjo periudhe mendohet te zgjase deri ne fund te vitit 2008. Duke filluar nga viti 2009, Drejtoria e Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave do te shkoje drejt vetefinancim ne perputhje me kushtet e realizimit te te ardhurave. Policia Pyjore kalon ne varesi te Ministrit te Bujqesise dhe Ushqimit.

Veprimet:

- Krijimi i strukturave te nevojshme ne funksion te detyrave perkatese.
- Forcimi i rolin kontrollues si mbrojtese e zbatimit te ligjit te policise pyjore.
- Ndarja e detyrave funksionale te percaktuara rigorozisht me rregullore apo ligj, pra te ndahen perfundimisht funksionet kontrolluese nga ato manaxheriale.
- Krijimi i strukturave zbatuese efektive te cilat do te qeverisin e administrojne pasurite pyjore e kullosore ne menyre te qendrueshme ne te gjitha nivelet.
- Organizimi nga DPPK te shërbimit këshillimor, duke krijuar zyra operative (apo agjentë operative) në teren në të gjitha nivelet.

- Perfshirja aktive te pushtetit vendor ne zhvillimin e sektorit te pyjeve e te kullotave.

Objektivi 3. Rritja e efektivitetit te policise se sherbimit pyjor.

Veprimet:

- Forcimi i policise pyjore me shkalle te gjere autonomie duke i dhene statusin e barabarte me policite homologe te vendeve te tjera te komunitetit European, por gjithmon duke qene strukture e DPPK.
- Funkcionet e policise pyjore te jene plotesishte te ndara nga funksionet menaxheriale te strukturave te tjera te DPPK
- Të forcohet sistemi i vrojtim-sinjalizimit për zjarret, demtuesit dhe sëmundjet epidemike në pyje, duke përcaktuar mënyrën e funksjonimit, ndërvarësitë, dhe aktorët që duhet të marin pjesë e duke e futur këtë problem në kategorinë e katastrofave natyrore. Për këtë të hartohet një rregullore ose një ligj i veçantë i cili të miratohet në nivel qeverie për të patur fuqi detyruese për aktorë që bëjnë pjesë në sisteme të ndryshme dikasteriale ose private.
- Policia pyjore të organizoj më mirë marjen e informacionit mbi dëmtimet në pyje e kullota dhe te zbatoj me rigorozitet ligjin e pyjeve.

Objektivi 4. Përsosja e strukturës së administratës pyjore, duke e lehtësuar e bërë atë më të zhdërvjellët dhe duke e afruar sa më shumë me bazën.

Veprimet:

- Adoptimi i një skeme më të lehtë organizimi për DPPK dhe me efektivitet te larte funksional.
- Krijimi i nje strukture funksionale e te pergjegjeshme te policise pyjore nga qendra ne baze.
- Krijimi i drejtorive pyjore rajonale per menaxhimin dhe qeverisjen e pyjeve të lartë, me vartësi direkte dhe unike nga DPPK.

Drejtimit strategjik. Vazhdimi dhe thellimi i reformimit dhe plotesimit te kuadrit ligjor dhe rregullator ne pershtatje me dinamizmin dhe sfidat e ekonomise se tregut te lire.

Legjislacioni i pershtatshem, sa me i plote, i harmonizuar dhe koherent dhe forcimi e respektimi i ligjit i shoqeruar me lehtesi ekonomike jane linjat kryesore per garantimin e suksesit. Harmonizimi i ligjit mbi pyjet me ligjet e tjera sektoriale do beje me te lehte arritjen e objektivave strategjike.

Objektivi 1. Hartimin e një ligji të ri pyjesh.

Veprimet:

- Hartimi i kuadrit ligjor e nenligjor qe do te sherbej per zgjidhjen e çeshtjeve te administrimit te fondit pyjor e kullosor te dhene ne perdorim/pronesi komunave si dhe sqaroj mbivendosjet me ligjet e tjera.

- Hartimi i statusit dhe rregullores se sherbimit keshillimor duke percaktuar detyrat, te drejttat dhe pergjegjesite.
- Permiresimi i akteve ligjore e nenligjore per pyjet dhe kullotat shteterore.
- Hartimi i akteve ligjore e nenligjore per perdorimin e pyjeve private.
- Hartimi i ligjit te ri te pyjeve si sintheze e ndryshimeve te krijuara pas decentralizimit te pronesise shteterore, duke theksuar te drejten e kontrollit nga sherbimi pyjor mbi te gjitha kategorite e pronesise mbi pyjet dhe kullotat.

9. MONITORIMI.

Monitorimi eshte procesi i nxjerrjes ne pah te ndryshimeve kur ato kane ndodhur, duke percaktuar drejtimin dhe matur shtrirjen e tyre. Kjo duhet shoqeruar me nje vleresim te rendesise se ndryshimeve te nxjerra ne pah.

Monitorimi duhet te jete nje pjese e qeverisjes normale te pyjeve dhe kullotave, per te siguruar informacion per menaxheret ne menyre qe te ndihmojne ne vandom - marrje. Monitorimi synon te arrije nje ekuiliber midis interesave te pylltarise dhe ruajtjes e permiresimit te mjedisit dhe jetes se eger.

Tani qeverisja me qellim mbrojtjen ka marre nje rendesi gjithmone ne rritje ne raportin ekosistem pyjor dhe pyll prodhues. Megjithate monitorimi i efekteve te qeverisjes se pyjeve per jeten e eger eshte vonuar mbrapa rritjes ne aktivitet dhe shpenzime.

Vegetacioni eshte shpesh i pershtatshem per monitorimin e ndryshimeve ne vlerat e jetes se eger, sepse siguron strehim dhe ushqim pwe kafshet, eshte relativisht i perhershem dhe i perdorshem dhe reflekton klimen, token dhe praktikat e perdorimit.

Monitorimi para se gjithash kerkon vendosjen e rrjetit te perhershem te monitorimit i cili perben nje objektiv strategjik per evidentimin e ndryshimeve ne ekosistemet e pyjeve dhe kullotave dhe nderhyrjen ne kohen me te pershtateshme per rehabilitimin e tyre.